

PROCESVERBAL

Nga Kuvendi i Dytë i Komunitetit Shqiptar të Gjenevës, i mbajtur me 06 prill 2014 në Gjenevë

Prezent, anëtarët e kryesisë: Ali Mehmeti, Avdyl Gërvalla, Arif Ejupi, Fadil Avdiqaj, Nebi Hyseni, Nexhmedin Ilazi, Nexhat Xhymshiti, Afërdita Krasniqi, Lutfi Rexha, Lah Jashari, Nasuf Nuhiu, Endri Veshi dhe Agim Sherifi.

Mungon me arsye, anëtari i kryesisë: Ajet Hyseni, sekretar

Mungojnë, anëtarët e kryesisë: Erenik Yzeiraj dhe Adrian Reka

Po ashtu në sallë janë të pranishëm edhe rreth 60 persona tjerë, anëtarë të Komunitetit Shqiptar të Gjenevës.

Mbledhjen hapi kryetari i KShGj-së z. Ali Mehmeti duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke propozuar rendin e ditës që u ishte dërguar anëtarëve të KShGj-së tre javë përpara me postë:

REND DITE

1. Aprovimi i procesverbalit nga Kuvendi i Parë (Themelues),
2. Paraqitja e raportit të punës për periudhën ndërmjet dy kuvendeve dhe aprovimi ose refuzimi i tij,
3. Paraqitja e raportit financiar dhe aprovimi ose refuzimi i tij,
4. Paraqitja e raportit të verifikuesve të kontos dhe aprovimi ose refuzimi i tij,
5. Zgjedhja e verifikuesve të kontos për vitin 2014,
6. Përcaktimi i shoqatave të cilat e kanë të drejtën të delegojnë nga një anëtar në kryesinë e KShGj-ës,
7. Plotësimi i vendeve të lira në kryesi me anëtarë/e të ri/reja
8. Të ndryshme
 - a) *Diskutimi rreth përkrahjes që KShGj i dha të vetmit kandidat shqiptar për Parlamentin e kantonit të Gjenevës (Grand Conseil) dhe nxjerrja e udhëzimeve për të ardhmen*
 - b) *Diskutimi rreth pozicionimit dhe pjesëmarrjes së KSHGj-së në referendumin e 24 nëntorit 2014 dhe nxjerrja e udhëzimeve për të ardhmen*
 - c) *Diskutimi për ose kundër publikimit të emrave të anëtarëve të KShGj-së në faqen tonë në Internet*

Ky rend dite u aprovua njëzëri dhe u kalua në pikën e parë.

1. Aprovimi i procesverbalit nga Kuvendi i parë (themelues)

Procesverbali nga Kuvendi Themelues i është dërguar të gjithë anëtarëve të KShGj-së paraprakisht ashtu që kanë pas mundësinë ta lexojnë më herët. Po ashtu ishte në dispozicion në formë të shkruar edhe në hyrje të sallës ku mbahej Kuvendi. Nuk pati asnjë vërejtje, ashtu që PV u aprovua njëzëri.

2. Paraqitja e Raportit të punës

Raporti i punës përfshin periudhën ndërmjet dy kuvendeve. Të pranishmëve në sallë iu është paraqitur në ekran me video-projektor. Anëtarëve të komunitetit i u është

dërguar paraprakisht me postë elektronike ashtu që kanë pasur mundësinë ta lexojnë më herët. Po ashtu ishte në dispozicion në formë të shkruar edhe në hyrje të sallës ku mbahej Kuvendi. Nuk pati asnjë vërejtje, ashtu që Raporti i punës u aprovua njëzëri.

3. Paraqitja e raportit financiar

Arkëtari, Nexhmedin Ilazi, paraqiti Raportin financiar që përfshin periudhën prej themelimit të shoqatës gjer më 31 dhjetor 2013. Anëtarëve të komunitetit i u është dërguar paraprakisht me postë ashtu që kanë pas mundësinë ta shikojnë më herët. Po ashtu ishte në dispozicion në formë të shkruar edhe në hyrje të sallës ku mbahej Kuvendi.

4. Paraqitja e raportit të verifikuesve të kontos

Verifikuesit e kontos, të emëruar në Kuvendin e Parë, Avdyl Hamza, Endri Veshi dhe Ilir Sahiti, paraqitën raportin e tyre të shkruar dhe nënshkruar. Ata konstatuan se raporti financiar është në përputhje me Statutin e shoqatës dhe ligjin, prandaj i propozuan Kuvendit ta aprovojnë.

Raporti u aprovua njëzëri.

5. Zgjedhja e verifikuesve të kontos për vitin 2014

Për verifikues të kontos janë propozuar nga publiku z. Përparim Arifi dhe Ilir Sahiti. Propozimi u aprovua njëzëri.

6. Përcaktimi i shoqatave të cilat e kanë të drejtën të delegojnë nga një anëtar në kryesinë e KShGj-së

Shoqatave të paraparë në Kuvendin e Parë i shtohen edhe shoqata "Medvegja" dhe shoqata "Smira" (sipas nenit 22 të Statutit).

7. Plotësimi i vendeve të lira në Kryesi të KShGj-së

Meqenëse anëtari i Kryesisë z. Ismet Kurteshi është zgjedhur deputet në Kuvendin komunal Onex, ai ka dhënë dorëheqje nga Kryesia. Në Kuvend është shtruar pyetja se a ka të interesuar që të bëhen anëtarë të Kryesisë. Ishte vetëm një i interesuar, z. Fadil Selmani, i cili njëkohësisht edhe do të përfaqësoj shoqatën "Medvegja".

8. Të ndryshme

a) Diskutimi rreth përkrahjes që KShGj i dha të vetmit kandidat shqiptar për Parlamentin e kantonit të Gjenevës (Grand Conseil) dhe nxjerrja e udhëzimeve për të ardhmen

Në këtë pikë ka pasur shumë diskutime. Shumica e folësve kanë thënë se ne duhet të përkrahim kandidatët shqiptar në institucione, sikur ato komunale ashtu edhe ato kantonale. Gabimi në rastin e kaluar ka qenë se kandidati nuk ka mbajtur tubime, ku publiku që nuk e njuh do ta njoftonte, dhe ku ai do të paraqitej synimet e tij, sikurse dhe në çfarë mënyre mendon të kontribuoj për komunitetin tonë. Për këtë arsye ndoshta edhe nuk ka arritur të zgjidhet në Parlamentin kantonal. Konkluzioni për të ardhmen është që gjithsesi duhet mbajtur kësi lloj tubimesh.

b) Diskutimi rreth pozicionimit dhe pjesëmarrjes së KSHGj-së në referendumin e 24 nëntorit 2014 dhe nxjerrja e udhëzimeve për të ardhmen

Kjo pikë ka shkaktuar më së shumti diskutime, shpesh diametralisht të kundërt:


- Disa mendojnë se nuk duhet të pozicionohemi në asnjë referendum sepse ky është akt politik, kurse ne jemi shoqatë jopolitike;
- disa të tjerë se duhet të deklarohemi sikurse edhe çdo shoqatë tjetër kur preken interesat e saj, pavarësisht se si do ta kuptojnë të tjerët këtë, si akt politik apo jopolitik;
- disa se nuk është dashur të deklarohemi sepse çështja rreth cilës jemi deklaruar nuk ka prek interesat tona dhe sidomos sepse jemi pozicionuar sikurse edhe partia UDC që ka urrejtje ndaj të huajve;
- disa se pozicionimi është në pajtim me Statutin e shoqatës dhe me ligjin, pra si i tillë duhet të mbetet edhe më tutje në Statut;
- disa se ka qenë gabim që nuk jemi pozicionuar kur ishte pyetja rreth kufizimit të imigrimit dhe përcaktimit të kuotave për të huaj. Ky referendum kaloi me 50,3%; por ndoshta me votat e shqiptarëve do parandaloheshin këto kufizime që po shkaktojnë kokëçarje edhe për vet shtetin e Zvicrës.

Si konkluzion: e drejta për t'u pozicionuar të mbetet në Statut, kurse në të ardhmen duhet analizuar më mirë çështjet për të cilat bëhet fjalë para se të marrim ndonjë qëndrim si KShGj.

c) Diskutimi për ose kundër publikimit të emrave të anëtarëve të KShGj-së në faqen tonë në Internet

Ka pasur mendime se nuk ka nevojë të shpallen emrat e anëtarëve të KShGj-së në sajtin tonë të internetit. Pas diskutimeve dhe votimeve, shumica vendosen që emrat të mbeten në sajt.

Procesmbajtës, anëtar i kryesisë
Fadil Avdija



Kryetar
Ali Mehmeti

